

Dëshmorët Leonti, Ipati, Theodhuli, Eteri. Oshënar Erazmi. Amandi i Bordosë



E enjte, 18 qershor 2026 – Shenjtori i ditës.

JEMI NË KRESHMËN E APOSTUJVE (8-28 QERSHOR)

Dëshmorët Leonti, Ipati, Theodhuli, Eteri. Oshënar Erazmi. Amandi i Bordosë.

– DËSHMORËT LEONTI, IPATI, THEODHULI –

Shën Leonti shërbente në ushtrinë romake gjatë mbretërimit të Vespasianit (rreth 69-79), dhe dallohej për trimërinë e tij. Në garnizon në Tripoli (Feniki), u shpërndau të varfërve të ardhura nga ushtria duke dënuar edhe idhujt. Këtë e mori vesh guvernatori i Fenikit Adriani, dhe dërgoi gjykatësin Ipati që ta kapnin Leontin. Kur arritën në afërsi të qytetit, Ipatin e zunë ethe të forta, dhe natën iu shfaq një engjëll që i tha: “Nëse do që të shërohesh, thirr tri herë Perëndinë e Leontit”, pastaj engjëlli u zhduk. Ipati bëri kështu dhe u lehtësua.

Të nesërmen, Ipati u kthye në qytet i shoqëruar nga ushtar Theodhuli. Takuan Leontin, i cili i përshëndeti dhe i ftoi në shtëpinë e tij. I priti me të gjitha të mirat dhe iu zbuloi se ishte ushtar i Krishtit. Ipati dhe Theodhuli i ranë në këmbë dhe iu përgjëruan t’i çlironte nga papastërtia e idhujtarisë që të bashkoheshin me Krishtin. Kur Leonti po lutej për ta, një re në qiell u shfaq dhe derdhte sipër tyre ujin e nevojshëm për pagëzim.

U ndriçuan dhe ecën me llambadhe në duar, në mes të qytetit. Kjo i egërsoi paganët. Pas dy ditësh, në qytet mbërriti Adriani, i cili i futi që të tre në burg. Leonti

i nxiste dy miqtë e tij tashmë, të qëndronin të fortë në çdo provë. Në mëngjes i sollën në gjyq para Adrianit. Leonti deklaroi se ishte bir i dritës së vërtetë dhe ushtar i Krishtit. Ia thyen kockat me shkopinj, por shenjt i paepur, e çuan sërish në burg. Erdhi radha e Ipatit dhe e Theodhulit, të cilëve Adriani u kërkoi se përse e kishin tradhtuar qeveritarin.

Ata u përgjigjën me guxim se tani i përkisnin ushtrisë së Mbretit qiellor. Atëherë Ipatin e varën në pemën e torturave dhe ia copëtuan trupin me thonjë hekuri. Theodhulin e shtrinë dhe e goditën pa mëshirë. Duke parë që shenjtorët nuk i nënshtonin dot me anë të torturave i nxorën përpara gjyqit dhe i dënuan me vdekje me prerje koke. Leontin e nxorën përsëri përpara gjykatës. U rrah egërsisht nga 4 ushtarë. Ia çorën trupin, e varën me kokë poshtë dhe e kamxhikuan. E çuan përsëri në burg. Një engjëll vinte dhe e ngushëllonte.

Të nesërmen e nxorën në shesh dhe e shtrinë në 4 shtylla, e goditën keq dhe shenjt i dorëzoi shpirtin e tij te Perëndia. Trupin e tij e vendosën besimtarët në portin e Tripolit, dhe një kishë të madhe ndërtuan për nder të tij. Shën Leonti u bë martiri më i nderuar në Feniki dhe një nga më të njohurit në tërë Lindjen e krishterë.

Sipas versionit sirian, Leonti ishte ushtar në Tripoli në kohën e Dioklecianit. U kthye në besim nga murgu Publius dhe e shpërndau pasurinë e tij te të varfrit. Të dy u denoncuan nga priftërinjtë paganë te gjyqtari Filerino; i kamxhikuan, dhe murgun Publius e internoi në Emesa. Shpejt ai u kthye në Tripoli dhe u bashkua me Leontin. I çuan para qeveritarit Firmilian dhe u torturuan: Publius vdiq rrugës ndërsa po transferohej në Tir, dhe Leonti vdiq nga goditjet e shkopinjve.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)